

KËRKIME GJUHËSORE

Erena HASKA

TEZAUURËT NË SHQIPËRI SI PJESË E SISTEMEVE TË ORGANIZIMIT TË DIJES

Abstrakti: Mes nevojës dhe detyrimit për krijimin Tezaurëve në gjuhën shqipe dhe konkretisht shtrirjen e përdorimit të tyre në sistemet informimit, ky punim do të analizojë problemet e krijuara nga mungesa e tij në sistemet e organizimit të dijes. Një praktikë e mirë në dy institucione shqiptare të përdorimit të mekanizmit të Tezaurit, do të sillen në vëmendje të publikut. Metodologjia e përdorur në këtë punim konsiston në një ndërthurje të burimeve parësore dhe dytësore. Burimet parësore të tilla si hulumtimi në 11 institucionet shqiptare publike dhe private të dokumentimit mbi përdorimin e mekanizmit të Tezaurit në proceset e dokumentimit të materialeve arkivore/bibliotekare dhe intervistat me stafin e këtyre institucioneve. Në vazhdim, janë konsultuar burime dytësore si literatura vendase dhe e huaj në këtë fushë. Ky punim sjellë përfundime që do të kontribuojnë në: a) përmirësimin e organizimit dhe transmetimit të dijes nëpërmjet përdorimit të mekanizmit të Tezaurit, b) theksimin e nevojës për hartimin e një fjalori Thesaurus të gjuhës shqipe që do të krijonte traditën për hartimin e Tezaurëve në disiplinat shkencore dhe c) në krijimin e mekanizmave gjuhësor të kompjuterizuar.

I. Hyrje: Leksikografia është fusha e parë, në të cilën gjen përdorim termi Tezaur (Thesaurus)¹. Tezaurët e parë në fushën e Leksikografisë u krijuan për të siguruar ndihmë në formulimin e ideve që do të kontribuonin në prodhimin letrar dhe shkencor të një vendi². Tezaurët kanë strukturë semantike, ku termat grupohen në përputhje me konceptin që ato shprehin. Përdorimet e Tezaurëve në fusha të ndryshme të dijes, erdhën si rrjedhojë e strukturës semantike që ato kanë³. Sot ky mekanizëm gjuhësor është pjesë e rëndësishme e sistemit të organizimit të dijes, që synon jo vetëm përshkrimin dhe sistemimin e dijes, por edhe transmetimin e saj tek publiku⁴.

Sistemet e Organizimit të Dijes (SOD) u referohen të gjitha formave të organizimit të informacionit dhe promovimit të dijes⁵. Rëndësia që sot kanë marrë këto sisteme, buron nga nevoja që kushdo nga ne sot ka për njohjen sa më të mirë

¹ J. Aitchison dhe S.D. Clarke, *The Thesaurus: a historical viewpoint, with a look to the future*, në "The Thesaurus: review, renaissance and revision", Vol.37 Nr.3/4, 2004, f. 5.

² P. Srinivasan, *Thesaurus Construction*, në "Information Retrieval: Data Structures & Algorithms", 2004, f. 179.

³ J. Aitchison dhe S.D. Clarke, *The Thesaurus: a historical viewpoint, with a look to the future*, në "The Thesaurus: review, renaissance and revision", Vol.37 Nr.3/4, 2004, f. 6.

⁴ E. Curras, *Ontologies, Taxonomies and Thesauri in Systems Science and Systematics*, New York, 2010, f. 9.

⁵ A. Shiri dhe K. Molberg, *Interfaces to knowledge organization systems in Canadian digital library collections*, në "Online Information Review", Vol.29 Nr.6, 2005, f. 604.

ERENA HASKA

të terminologjisë në disiplinën shkencore ku kontribuon, por edhe njohjes së zhvillimit historik që kjo disiplinë ka pasur⁶. E. Curras saktëson që SOD mund të lehtësojnë zbulimin e dijes dhe kuptimin e burimeve të informacioni, duke ofruar qasje lëndore, duke shtuar mënyra të të kuptuarit të sistemit, duke mbështetur qasje shumëgjuhëshe dhe duke ofruar subjekte për zgjerimin e kërkimit të tekstit të lirë dhe duke lejuar që kulturat e ndryshme të ndikojnë dhe të bashkëveprojnë midis tyre me mënyra të ndryshme.⁷

SOD, bazuar në kompleksitetin e tyre të funksionimit klasifikohen sipas Hodges në⁸:

- *Sistemet e klasifikimit, kategoritë lëndore, taksonomitë dhe ontologjitë që organizojnë materialet në një nivel të përgjithshëm.*
- *Katalogët e kryetitujve lëndorë, që sigurojnë një qasje në detajet.*
- *Katalogët e termave si p.sh. Arkivat e Emrave të Përcaktuar, të cilët kontrollojnë botime të ndryshme të të dhënave, si emrat e njerëzve, organizmave, emrat e vendeve etj.*
- *Katalogët të Subjekteve Relativë, ku futen edhe Tezaurët, por edhe disa sisteme tradicionale të SOD.*
- *Ontologjitë që janë struktura koherente.*

Tezaurët, ashtu si përmendëm më sipër janë mekanizma shumë të rëndësishëm që bëjnë pjesë në SOD. Janë dizenuar për përdorim brenda një discipline shkencore specifike dhe si mekanizma që shfrytëzohen gjerësisht në sistemet e bazave të të dhënave⁹. Tezaurët nuk përmbajnë vetëm terminologji të kontrolluar për prezantimin e dijes, por më tepër ato shfaqin të gjithë dijen brenda një discipline shkencore, specifikojnë ambientin kontekstual që do të përdoret në SOD¹⁰. Studiuesit Aitchison dhe Bawden theksojnë që tezauri është një fjalor i një gjuhe të kontrolluar indeksimi, i organizuar në mënyrën që të bëhen të qarta marrëdhëniet hierarkike, të ekuivalencës dhe marrëdhëniet e asociuara ekzistuese midis koncepteve¹¹. Kjo struktura ka dy qëllime, së pari, përmirëson njohjen e kuptimit të konceptit brenda një discipline shkencore, duke bërë të mundur që ky koncept të përdoret për qëllime didaktike¹². Së dyti ndihmon në formulimin e

⁶ K. Jorna dhe S. Davies, *Multilingual thesauri for the modern world: no ideal solution?*, në "Journal of Documentation", Vol. 57 Nr. 2, 2001, f. 286.

⁷ E. Curras, *Ontologies, Taxonomies and Thesauri in Systems Science and Systematics*, New York, 2010, f. 5-9.

⁸ A. Friedman dhe M. Thellefsen, *Concept theory and semiotics in knowledge organization*, në "Journal of Documentation", Vol. 67 Nr. 4, 2010, f. 646.

⁹ J. Abbas, *Structure for Organizing Knowledge: exploring taxonomies, ontologies and other schemas*, New York, 2010, f. 120.

¹⁰ J. Abbas, *Structure for Organizing Knowledge: exploring taxonomies, ontologies and other schemas*, New York, 2010, f. 120.

¹¹ D. Tudhope dhe të tjerë, *Query expansion via conceptual distance in thesaurus indexed collections*, në "Journal of Documentation", Vol. 62 Nr. 4, 2006, f. 509.

¹² C. Beghtol, *A proposed ethical warrant for global knowledge representation and organization system*, në "Journal of Documentation", Vol. 58 Nr. 5, 2002, f. 286.

pyetjeve në sistemet e gjetjes së informacionit, sepse teknologjia nuk mund të kapërcejë problemet intelektuale të semantikës ekuivalente, gjithashtu edhe kompleksitetin që paraqet gjuha natyrale¹³. Duke sintetizuar në fushën e dokumentimit Tezaurët garantojnë¹⁴: **a)** prezantimin e strukturës konceptuale të një fushe të dijes **b)** kontrollin e përdorimit të termave, duke neutralizuar përdorimin e sinonimeve dhe polisemisë që janë karakteristika të gjuhës **c)** indeksimin e informacionit **d)** konsultimin dhe kërkimin e sistemit nga përdoruesit për lokalizimin e informacionit dhe **dh)** gjetjen e informacionit.

Ky studim ka si objektiva: a) të bëjë publike përdorimin e mekanizmit të Tezaurit në institucionet shqiptare të dokumentimit dhe të analizojë nëse ky mekanizëm është ndërtuar me bazë të standardeve gjuhësore dhe standardeve ndërkombëtare të ndërtimit të Tezaurit, b) të inventarizojë llojet e SOD që përdoren në institucionet shqiptare të dokumentimit për ti njohur dhe kuptuar nëse janë të mjaftueshëm për organizimin e dijes dhe transmetimin e saj dhe c) të nënvizojë nevojën e krijimit të një Tezauri unik për të gjitha institucionet shqiptare të dokumentimit që do të bënte të mundur unifikimin e terminologjisë në fushën e dokumentimit.

II. Metodologjia

Ky punim është bazuar në pyetësorët të realizuar në 11 institucione shqiptare publike dhe private (Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Arkivi i Institutit të Historisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Arkivi Audiovizual i Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit (IAKSA), Arkivi i Fondeve Materiale Etnografike të IAKSA, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit (AQSHF), Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë (BKSH), Biblioteka e Universitetit të Arteve (BUA), Biblioteka e Universitetit New York, Biblioteka e Universitetit Luigj Gurakuqi, Arkivi i Televizionit Kombëtar Top Channel (Arkivi TCH). Janë përzgjedhur këto institucione si pjesë e hulumtimit me kriterin se këto institucione kanë koleksione digjitale dhe baza të dhënash në formë elektronike dhe përdorimi i SOD është i detyrueshëm, në mënyrë që komuniteti i përdoruesve të shfrytëzojë sa më me produktivitet fuqinë e orientimit që ato ofrojnë.¹⁵ Opinione të stafit të institucioneve të dokumentimit janë nxjerrë duke përdorur pyetësorët e strukturuar, ndjekur edhe me intervistat gojore.

Pyetësorët u plotësuan nga 11 (100%) drejtuesit ose personat përgjegjës për dokumentimin e materialeve bibliotekare/arkivore në institucionet e dokumentimit në vend. Të dhënat e mbledhura janë paraqitur në tabela dhe të grupuara sipas llojit të institucionit: arkivor dhe bibliotekar.

Gjithashtu, janë konsultuar burime dytësore si literatura vendase dhe e huaj në këtë fushë.

¹³ C. Beghtol, A proposed ethical warrant for global knowledge representation and organization system, në "Journal of Documentation", Vol. 58 Nr. 5, 2002, f. 285.

¹⁴ A. Skandali, Subject Indexing: post coordinate systems, Athinë, 1990, f. 47.

¹⁵ A. Shiri dhe S. Chase Kruszewski, *Knowledge Organization systems in North American digital library collections*, në "Program: electronic library and information systems", Vol. 43 Nr. 2, 2009, f. 122.

III. Rezultatet

Të dhënat e mbledhura mbi llojet e koleksioneve digjitale që gjenden në institucionet arkivore dhe bibliotekare, paraqiten në Tabelën 1.

Tab. 1. Llojet e koleksioneve digjitale	
Lloji i bibliotekës digjitale	Nr. i konstatuar
E përgjithshme	0
Specifike - Albanologjike	2
Specifike – Lëndore	1
Lloji i arkivës digjitale	Nr. i konstatuar
E përgjithshme	3
Specifike - Albanologjike	4
Specifike – Lëndore	0

Institucionet arkivore dhe bibliotekare të dokumentimit, të cilat janë pjesë e këtij hulumtimi, përdorin mekanizma të ndryshëm për organizimin e dijës. Tabela 2 tregon llojet e mekanizmave të SOD që përdoren në këto institucione.

III. Diskutimet

Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të mekanizmave të SOD në institucionet e dokumentimit tregon profesionalizimin dhe koherencën e tyre në misionin për të ofruar shërbime kualitative ndaj

përdoruesve të tyre. Më lejoni të analizoj rezultatet e nxjerra nga tabelat më sipër. Një konstatim i rëndësishëm i këtij punimi është që pjesa më e madhe e institucioneve të dokumentimit kanë filluar të digjitalizojnë koleksionet e tyre unikalë dhe me vlerë kombëtare. Këto suksesshme, duke krijuar një fond digjital albanologjik të qasshëm nga të gjithë shqiptarët brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Një pjesë e mirë e këtyre vlerave që janë digjituara janë pjesë e rrjeteve ndërkombëtare dhe evropiane të trashëgimisë kulture botërore.

Të dhënat nga Tabela 2 tregojnë që institucionet arkivore dhe bibliotekare të dokumentimit të hulumtuara përdorin SOD të ndryshme. Rezulton që bibliotekat përdorin shumëllojshmëri të SOD, për indeksimin dhe gjetjen e informacionit, ndërsa institucionet arkivore që pas viteve 1990 kanë ndaluar punën me analizimin lëndor të dokumenteve arkivore dhe si rrjedhojë sistemet që ato përdorin janë shumë pak dhe aspak të pasuruara dhe të zhvilluara. Gjetje e rëndësishme e këtij punimi është se bibliotekat janë më të hapura në përdorimin e sistemeve të gatshme, të cilët janë përshtatur sipas

Tab. 2. Llojet e SOD	
KOS që përdoret	Institucione
Emërtimet Lëndore të Bibliotekës së Kongresit	4
Emërtimet lëndore te Sears	1
Tezaurët	3
Taksonomitë e zhvilluara lokalisht	7
Lista të Autorëve	6
Sistemi i Klasifikimit Dhjetor Universal (UDC)	3
Sistemi i Klasifikimit i Bibliotekës së Kongresit	1
Lista gjeografike	3
Lista lëndore alfabetike	8

nevojave të institucionit. Konstatim krejt i ndryshëm vihet re në institucionet arkivore që në bazë të specifikave dhe nevojave të tyre, këto institucione kanë krijuar vetë mekanizmat lëndore.

Një tjetër gjetje shumë e rëndësishme e këtij studimi është se në tre institucione të dokumentimit (BKSH, Arkivi TCH dhe BUA) përdoret mekanizmi i Tezaurit. Tezauri që përdoret në dy institucionet bibliotekare ka si autor BKSH, dhe është i ndërtuar mbi Listën Lëndore të Sears-it (Sears List of Subject Headings) dhe Listën e Emërtimeve Lëndore të Bibliotekës së Kongresit (Library of Congress Subject Headings). Tezauri është pasuruar me terma që lidhen me kontekstin shqiptar si historinë e Shqipërisë, gjuhën shqipe etj.¹⁶ Në BUA, ky mekanizëm është në formë të printuar dhe këshillohet vetëm nga indeksuesit. Ndërkohë që BKSH që në vitin 1994, sistemin e Tezaurit e hedh në sistemin e menaxhimit të bibliotekës ADLIB, ku pjesë e këtij sistemi të integruar është edhe moduli i Tezaurit. Ky modul menaxhohet nga grupi i punës që njihet si autori i këtij mekanizmi dhe gjendet pranë BKSH.

Mekanizmi i Tezaurit nga hulumtimi i bërë në 7 institucionet arkivore, rezultoi që vetëm në Arkivin TCH përdoret. Tezauri është në formë elektronike. Po pyetja që lind është, a janë ndërtuar këto dy mekanizma me bazë standartet ndërkombëtare të ndërtimit të Tezaurëve dhe standardeve gjuhësore të gjuhës shqipe? Analiza e ndërtimit të tyre është realizuar me bazë kriteret e ndërtimit të Tezaurit njëgjuhësh¹⁷:

Përzgjedhja e Termave: Leksiku i përdorur në të dy Tezaurët që po analizojmë është leksik i përgjithshëm terminologjik¹⁸ dhe ka si pjesë të termave themelore që shprehin konceptet bazë më të rëndësishme të sistemeve dhe të nënsistemeve konceptore të fushave të ndryshme të dijes.

Leksiku është i përbërë nga terma emërorë dhe togfjalësia emërorë të shkëputur me përzgjedhje nga nënsistemet e ndryshme terminologjike të fushave të dijes. Krijimi i Tezaurit ka filluar me procesin e identifikimit të termave. Termat janë identifikuar nga autorët në rrafshin e funksionimit të tyre si shënues të një koncepti të veçantë brenda dijes.¹⁹ Por çështja e identifikimit të një njësie leksikore si term në kategori të ndryshme të teksteve apo koleksioneve apo informacioneve lidhet me këndvështrimin prej të cilit nisemi dhe mbi të cilin mbështetemi për ta cilësuar një njësi si term²⁰. BKSH për të shmangur konceptimet e gabuara gjatë procesit të identifikimit të termave, identifikimin e termave e ka bërë duke u mbështetur në Listën Lëndore Sears dhe në Emërtimet

¹⁶ Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, *Listat e emërtimeve lëndore*, Tiranë, 2001, f. II.

¹⁷ Shih më gjerë: UNESCO, *Guidelines for the Establishment and Development of Monolingual Thesauri*, Paris, 1971, f. 7-21.

¹⁸ A. Duro identifikon katër shkallë të leksikut për identifikimin e tij: 1. Leksiku terminologjik bazë 2. Leksiku i përgjithshëm terminologjik 3. Leksiku terminologjik tërësor dhe 4. Leksiku terminologjik i një fushe të veçantë dije. Shih më gjerë A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 16.

¹⁹ A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 19.

²⁰ A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 32.

ERENA HASKA

Lëndore të Bibliotekës së Kongresit, pra duke përdorur lista të gatshme të termave. Ndërsa përzgjedhja e tyre është bërë, duke pasur parasysh nevojat e bibliotekave në Shqipëri. Termat që janë përdorur janë njëfjalësh emëror dhe togfjalësh emërorë. Ndërsa Arkivi TCH, në mungesë të një modeli të gatshëm, apo të një taksonomie të gatshme, identifikimin e termave e ka bërë duke përdorur mjete të ndryshme të komunikimit si tekste publicistike, politike, ekonomike, sociale, mjekësore në formë elektronike dhe të printuar, fjalorët terminologjikë, Fjalorin e Gjuhës Shqipe etj. Në këto kushte, sipas Agron Duros “*del e nevojshme qysh në fillim të paraqiten disa tipare themelore për përcaktimin e caqeve brenda të cilëve do të identifikoheshin njësitë leksikore si terma*”²¹. Prandaj si tipar themelor i identifikimit të një termi u vendos nga autorët që do të ishte lidhja e tij e drejtpërdrejt me konceptim që ai shpreh. E njëjta logjikë është përdor edhe me togfjalëshat e qëndrueshëm dhe të lirë të tipit emëror, me kushtin që do të identifikohen si terma për Tezaurin, të gjithë togfjalëshat e tipit emëror që shënojnë nëpërmjet lidhjeve të gjymtyrëve të tyre objekte të veçanta ose dukuri të konceptuara si entitete më vete²². Për togfjalëshat me mbi tre fjalë, gjuhëtarët mendojnë që duhen shmangur nga fjalorët terminologjikë dhe mekanizmi që sugjerojnë është copëzimi i tyre, duke rritur shkallën e përgjithësimin të termit²³. Për hartuesit e Tezaurit, shmangia e togfjalëshave me mbi tre fjalë ka qenë shumë e vështirë. Ashtu si edhe Valter Memisha shpjegon që sot janë rritur ndjeshëm togfjalëshat terminologjikë, që lidhen me ekonominë e tregut, me financat, me informatikën, me politikën, me drejtësinë etj., sepse është rritur shumë pesha specifike e profesioneve me të cilët këta terma janë të lidhur²⁴.

Nga ana e ndërtimit gramatikor togfjalëshat e tipit emëror përbëhen nga: **a)** emër + emër + emër + emër + emër²⁵ (në tezaurin e Arkivit TCH) ose emër + emër (në tezaurin e BKSH), **b)** emër + mbiemër, **c)** emër + parafjalë + emër.

Dukuritë semantike tregohen në Tezaurët nëpërmjet deklarimit të marrëdhënieve midis termave, duke përdorur treguesit: **BT** (Broader Terms) =

²¹ A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 35.

²² A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 150 (Këtu autori identifikon që të gjithë togfjalëshat e qëndrueshëm, duke shënuar nëpërmjet lidhjeve të qëndrueshme të gjymtyrëve të tyre objekte të veçanta të konceptuara si entitete më vete të realitetit, paraqiten si një mjet i efektshëm me një lehtësi të madhe formimi për plotësimin e nevojave të terminologjive të fushave të ndryshme të dijës. Ata e pasurojnë leksikonin me njësi të reja, krahas mjeteve të tjera fjalëformuese....).

²³ A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 173 (...Thjeshtimi ose copëtimi i termit togfjalësh të zgjeruar nxjerr në pah aftësinë abstraguese të tij ...Kjo veti i jep termit një fuqi të madhe përgjithësuese....).

²⁴ V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011, f. 159.

²⁵ Shih me gjere: V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011, f. 152 (...Termat togfjalëshat të zgjeruar janë formuar nga bashkimi i fjalëve nga 2-6 terma. H. Pasho pranon terma togfjalëshat me 3-6 përbërës (madje ajo pranon se ka terma edhe me 8 përbërës) dhe ne varësi prej strukture, lidhjeve sintaksore e semantike etj., pranon se brenda një termi mund të kemi edhe 4 bërthama).

TEZAURËT NË SHQIPËRI SI PJESË E SISTEMEVE TË ORGANIZIMIT TË DIJES

“Subjekte më të Gjera”; **NT** (Narrower Terms) = “Subjekte më të Ngushta”; **RT** (Relative Terms) = “Subjekte Relativë”; **USE**: subjekti që ndjek këtë tregues, është subjekti i preferuar; **UF (Use For)**: subjekti që ndjek këtë tregues, është subjekti jo i preferuar.

Lidhja e termave është një nga aspektet më të rëndësishëm në një Tezaur, sepse demonstroi nivele të specifikimit të nevojshëm²⁶. Tezauri i BKSH tregon: **1)** lidhjet e ekuivalencës dhe **2)** lidhjet hierarkike. Ndërsa Tezauri i Arkivit TCH përveç lidhjeve të ekuivalencës dhe lidhjeve hierarkike tregon edhe lidhjet johierarkike.

Struktura gramatikore e termave në Tezaurin e BKSH është: *emër në numrin njëjës në trajtën e shquar dhe emër në numrin shumës në trajtën e pashquar*. Ndërsa struktura gramatikore në Tezaurin e Arkivit TCH është: *emër në numrin njëjës në trajtën e shquar dhe emra në numrin shumës në trajtën e shquar*. Te dyja institucionet kanë aplikuar disa kritere për përzgjedhjen e numrit të termave²⁷:

a) për objektet konkrete

- Përdoret numri shumës për termat që mund të maten dhe i përgjigjen pyetjes “SA” p.sh. *Dritaret etj.*
- Përdoret numri njëjës për termat që nuk mund të maten p.sh. *Vaji, Uji etj.*
- Termat që përfaqësojnë klasën e tyre, i përdorim në numri shumës p.sh. *Ngjyrat etj.*

b) për termat abstrakt

- Përdoret numri njëjës për termat që tregojnë cilësi, besim fetar, veprimtari ose funksion dhe disiplinë shkencore p.sh. *Shpejtësia, Oratoria etj.* dhe *Katolicizmi, Judaizmi, Myslimanizmi etj.* dhe *Revolucioni, Frymëmarrja dhe Fizika, Mjekësia etj.*

c) por përdoren të dy numrat për termat që mund të jenë të njëjtë, por marrin kuptime të ndryshme p.sh. *Druri*(si material) dhe *Drutë* (si materiale që digjen). Struktura gramatikore e termave togfjalësha behet sipas shkallës së njohjes dhe e përhapjes së tyre në ligjërimin e përgjithshëm²⁸.

Niveli i kordinimit të termave: Niveli i koordinimit në një tezaur është shumë i rëndësishëm, pasi tregon kompleksitetin, saktësinë e fjalorit, por tregon edhe numrin e kombinimeve që termat kanë brenda një tezauri²⁹. Tezauri i BKSH është tezaur i postkoordinuar, ku grupimi i fjalëve nuk lejohet, ato krijohen gjatë procesit të kërkimit³⁰. Ndërsa tezauri i Arkivit TCH është tezaur i parakoordinuar.

²⁶ P. Srinivasan, *Thesaurus Construction*, 2004, f. 182, në “Information Retrieval: Data Structures & Algorithms”.

²⁷ A. Skandali, *Subject Indexing: post coordinate systems*, Athinë, 1990, f. 23-32.

²⁸ V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011, f. 153.

²⁹ P. Srinivasan, *Thesaurus Construction*, 2004, f. 181, në “Information Retrieval: Data Structures & Algorithms”.

³⁰ P. Srinivasan, *Thesaurus Construction*, 2004, f. 181, në “Information Retrieval: Data Structures & Algorithms”.

Standartet e përdorura: Tezaurët e të dy institucioneve janë të ndërtuar bazuar në standardin për ndërtimin e tezaurëve njëgjuhësh ISO 2788. Gjithashtu për ndërtimin e strukturave gramatikore të termave janë këshilluar fjalorët e gjuhës shqipe: “Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe”, katër fjalorët shpjegues të gjuhës së sotme shqipe (‘80, ’84, ’02, 06), dy “Gramatikat” e Akademisë së Shkencave³¹, fjalorët terminologjikë të disiplinave të ndryshme.

Konsultimet me ekspertët: Prania e terminologëve dhe gjuhëtarëve në grupet e punës për ndërtimin e Tezaurëve, konsiderohet shumë e rëndësishme, pasi do të ofronin kontributin e tyre të çmuar në procesin e përzgjedhjes së termave, në çështjet e strukturave gjuhësore, veçanërisht në marrëdhëniet semantike që termat kanë midis tyre, por edhe në kushtet e mungesës së një fjalori Thesaurus të gjuhës shqipe. Nga ky hulumtim, konstatojmë se në grupet e punës për ndërtimin e Tezaurëve në të dy institucionet, gjuhëtarët dhe terminologët nuk kanë qenë pjesë e tyre, por autorët konfirmojnë se konsultimet për probleme të caktuara kanë ekzistuar.

Përdoruesit: Tezaurët e ndërtuar në të dyja institucionet nuk janë të dukshëm për përdoruesit e tyre. Por autorët konfirmojnë që Tezaurët i shërbejnë komunitetit të përdoruesve.

Mirëmbajtja: Krahasuar me leksikon e përgjithshëm, leksiku terminologjik në tërësinë e tij shërben për të shprehur konceptet e pafundme të fushave të shumta të dijes, prandaj dhe ai paraqitet i pafundmë si sasi³². Ky konstatim i detyron krijuesit e Tezaurëve që të programojnë mirëmbajtjen e tij në vazhdimësi. Tezaurët në të dyja institucionet kontrollohen rregullisht sipas një procedure të mirë përcaktuar më parë. Hyrja e termave të rinj bëhet pas marrjes së miratimit nga grupi i krijuesve me qëllim shmangien e konflikteve potenciale me termat ekzistues.

IV: Konkluzionet

Ky studim mund të konkludojë në: a) institucionet e dokumentimit që ishin pjesë e studimit, përdorin SOD të ndryshme. Institucionet bibliotekare në dallim nga institucionet arkivore përdorin SOD të njëjta. Ky konstatim të çon në përfundimin që rruga drejt unifikimit në përdorimin e terminologjisë është shumë më e shpejtë dhe e garantuar sesa në institucionet arkivore, të cilat që nga viti 1990 kanë ndërprerë punën me indeksimin lëndor të materialeve arkivore; b) në dy institucione të dokumentimit përdoret mekanizmi i Tezaurit në formë elektronike. Tezaurët e hartuar janë mekanizma shkencorë, të ndërtuar me bazë standardin e Tezaurëve njëgjuhësh; c) në dritën e standardeve dhe modeleve ndërkombëtare dhe kushteve në Shqipëri, ku veprimtaria institucionale e institucioneve të dokumentimit e ka kaluar gjysmën e shekullit, institucionet e dokumentimit gjenden në procesin e dyfishtë të hapjes dhe të integritetit³³. Në këto kushte, institucionet e dokumentimit në Shqipëri duhet të kenë një normë të

³¹ Sh. Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 159.

³² A. Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 15.

³³ S. Koçi, *Fjalor i Terminologjisë arkiore: shqip, anglisht, frëngjisht*, Tiranë, 2001, f. 6.

TEZAURËT NË SHQIPËRI SI PJESË E SISTEMEVE TË ORGANIZIMIT TË DIJES

eurokodifikuar me pikënisje një marrëveshje themelore për kuptimin e termave³⁴ dhe për organizimin e dijes. Këto institucione duhet të kenë një mekanizëm të fjalorit të kontrolluar hierarkik dhe me lidhje semantike që do të përfshinte jo vetëm termat që janë të ngjashëm në pjesën më të madhe të këtyre institucioneve (kjo konstatohet nga fushat që ato mbulojnë), por edhe me terma specifike të koleksioneve të tyre. Ky mekanizëm do të garantonte standardizimin e terminologjisë në institucionet e dokumentimit në nivel kombëtar, kaq të nevojshëm për të gjitha institucionet e dokumentimit në vend.

³⁴ S. Koçi, Fjalor i Terminologjisë arkiore: shqip, anglisht, frëngjisht, Tiranë, 2001, f. 6.